




Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 26/06/2020 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 29.05.2020

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit


Predrag Grbic





Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Štrpce



PROCESVERBAL

Nga seanca e tretë të rregullt e KK-ës të mbajtur më 29.05.2020, me fillim në ora 10:00

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së së Shtërpçës
3. Informimi nga shtabi i krizës lidhur me situatën e krijuar me COVID -19 në Komunën e Shtërpçës
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për formimin e grupit punës për hartimin e planit akcionar për pjesëmarrjen e publikut në aprovim e buxhetit të komunës për 2021-2023
5. Propozim dhe shqyrtimi raportit tremujor financiar për periudhën janar-mars 2019 dhe raporti mbi nivelin e pagesës së hyrave vetanake
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Drejtorisë për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave „ Razim Cokli” në Brod dhe Anton Santori” në Biti

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

Predrag Grbic: Nuk jemi parë një kohë të gjatë, arsyet i din të gjithë, edhe sepse sot është 29 maj, ne po mbajmë seancën e tretë të rregullt. Në seancën e sotme janë të pranishëm 15 këshilltarë, që do të thotë se kemi kuorum dhe mund të fillojmë me punë. Para se të fillojmë me rendin e ditës, kisha lexuar pjesë më të rëndësishme të letrës që kam marr nga MAPL, ku thuhet se komunat janë të detyruara të respektojnë masat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë së Kosovës, siç janë: distancë fizike, kjo është ajo që kemi bërë tani, bartja e maskës dhe dorezave, dezinfektimi i hapësirave publike ku zhvillohen seancat. Dezinfektimi i kësaj salle ishte bërë kur ishte dezinfektuar e gjithë ndërtesa e komunës, dhe ne e kemi dezinfektuar atë edhe pasi u mbajtjes së Komiteteve. Unë po kërkoj nga të gjithë këshilltarët që të respektojnë këto masa dhe të vendosin maska dhe doreza, kjo është kryesisht për shkak të

shëndetit tonë. Tani mund të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Ne kemi plan pune që kemi miratuar në dhjetor, por kemi anashkaluar dy seanca, kështu kemi ardhur në situatë ku ne nuk mund të punojmë në përputhje me planin e punës. Unë jem marr vesh me njerëzit nga ekzekutive që këto pika që janë në planin e punës dhe ato që do të jenë në rendin e ditës më vonë duhet të bëhen gjatë këtij viti, që do të thotë se me siguri do të kemi ndonjë seancë të jashtëzakonshme, si dhe ka mundësia që të punojmë në gusht, për të kompensuar të gjitha pikat që janë planifikuara me planin e punës. A lajmërohet dikush për fjalë?

Rifat Rustemi: Përshëndetje për të gjithë pranishëm, sa për rendin e ditës e kisha pasur vetëm një koment, pasi janë masa adekuate ashtu siç e ka dhënë edhe Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal dhe Instituti i Shëndetësisë Publike, na e kemi zbatuar ato masa si komunë, besoj që nuk ka pasur nevojë për të eliminua piken e ndryshme, keni menduar që të shkurtoni kohen, për shkak të situatës, keni menduar mirë, tu pas parasysh masat, distanca respektohet gjithçka është në rregull, nuk besoj që na kish marr kohë, nuk kisha larguar piken të ndryshme, sepse afër tre muaj nuk kemi pasur seancë.

Predrag Grbic: Do të përpiqem t'ju përgjigjem. Atëherë kur janë ndërmarr masat nga Ministria e Shëndetësisë, ne kemi biseduar me njerëzit nga pushteti ekzekutiv, për mundësitë e mbajtjes së një seance të jashtëzakonshme, nëse situata e kërkon atë. Faleminderit Zotit nuk kemi pasur një situatë të tillë, por kur kemi marr një letër nga MAPL, dhe kur ne kanë treguar që kushtet për mbajtjen e Kuvendit duhet të përmbushen, duke e caktuar masa të caktuara, ku shëndeti ishte i rëndësishëm për ne, në radhë të parë, dhe pastaj me mbajt Kuvendin. Pasi kemi qenë të sigurt se kjo sallë është dezinfektuar, ne kemi zgjedhur këtë sallë dhe kemi pa se sa njerëz mund të zënë, duke respektuar të gjitha masat. Askush nuk hyri këtu pas Komitetit, dhe pas Komitetit ne e kemi dezinfektuar atë, pasi nuk ka mundësi që të gjithë drejtorët të jenë të pranishëm në sallë, a pika e ndryshme kërkon që janë të pranishëm të gjithë drejtorët, për të marrë përgjigje në pyetje, por ju mund të paraqisni pyetje me shkrim dhe të më dorëzoni mua, si Kryesuesit e Kuvendit, sekretarit ose administratës dhe më pas do të merrni përgjigje për pyetjet tuaja, që ju do të bëni nën piken e ndryshme. A lajmërohet edhe dikush për fjalë? Pasi nuk lajmërohet askush e qes në votim.

Konstatohet që me një zë të njëjti kemi aprovuar këtë pikë

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar KK Shtërpce

Rifar Rustemi: Sa e përket procesverbalit jemi tu pasur probleme edhe kam tentuar që të analizoj ku po qëndron problemi, por unë personalisht kam ardhur në përfundim, se problemi është në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe nuk ka probleme sa kam mundur me vërejtje unë, problemi meshuam është në tekstin në gjuhën shqipe, për arsye të procesverbali po bëhet fillimisht në gjuhën serbe, pastaj po përkthehet në gjuhën shqipe, mirë procesi kur bëhet në gjuhën serbe ai e merr vetëm fjalë e përkthyesit, edhe përkthyesi nuk mund të kap krejt fjalë tona që diskutojmë këtu, sepse edhe na nuk mund të përmbahemi atë ritëm për të dhënë hapësirën përkthyesit me

përkthye, ka një here po nxitojmë, ka një here kemi emocione, por problemi ekziston, ja hup kuptimin fjalës, dmth. komplet, nuk është pak, është mirë ju kryesues me marr një here një procesverbal edhe qeto fjalët që janë shënuar, me marr edhe me interpretuar për shembull një përkthyesi, ti do të kuptosh edhe vet që nuk ka asnjë kuptim, nëse thamë ndalohet ai thotë lejohet, ajo është shumë kontradiktore, edhe del shumë e paqartë, edhe duhet të merrni masa pasi xhirimi nuk shpërndahet, që kjo që është në letër të jetë e sakët, te faqja e fundit, edhe apët nuk ka numri i faqes, është një problem teknik që vazhdon, është mirë më pas, sepse unë qetash kur flas për faqen e tret, nuk dihet cila është faqja tret ose katër. Problemi ma i madh është që po humb kuptimi i fjalëve, për shembull, unë kam folur për kanalizim të shkolla fillorë „Razim Cokli” në Brod, dhe kamë than që nuk ka kanalizim dhe shkolla është më gropë septike, këtu thuhet që nuk ka gropë septike, ashtu po del që nuk ka as kanalizim, as gropa septike, a atë ekziston gropa septike. Ka pasur rast kur kam folur për ndalim i prerjes së ilegale e pyjeve, dhe procesi kur ka ardhur atë ka shkruar është bërë ndalimi i shitjes së pive alkoolike, krejt diçka tjetër, është shumë pa kuptim. Është mirë që atë më pas pak kujdes, më përmirësuar pak procesin, ose më gjet zgjidhje.

Predrag Grbovic: Kur bëhet fjalë për procesverbalin, sekretari për punën e Kuvendit i bën procesverbalet në mënyrë që ato që thuhet në gjuhën serbe, ai i shkruan ato në gjuhën serbe dhe më pas ia dorëzon atë version në serbisht përkthyesit dhe përkthyesi e përkthen atë version që është në serbisht. Kur bëhet fjalë për shqipen, ai përkthen nga shqipja dhe më pas përkthyesi përkthen nga shqipja në serbisht. Kjo është procedura. Me të vërtetë më keni befasuar sepse kam lëvdata të mëdha për përkthyesin tonë. Kam shkruar në shumë takime dhe mund t'ju them se përkthyesit nuk ishin aq të mirë sa përkthyesi ynë. Do të mundohemi, natyrisht, për të shmangur përsëri gabime të tilla. A lajmërohet edhe dikush për fjalë? Pasi nuk lajmërohet askush e qes në votim.

Konstatohet se me 14 vota për, me 1 abstenime, kemi aprovuar rendin e ditës

3. Informimi nga shtabi i krizës lidhur me situatën e krijuar me COVID -19 në Komunën e Shtërpeës

Sasa Krsticic: Menjëherë pas shpërthimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID – 19, dhe në përputhje me statutin e Komunës së Shtërpeës, kryetari i komunës ka marr një vendim për formimin e shtabit të krizës në 15 mars 2020, me qëllim parandalimin e pandemisë së virusit KORONA në komunën e Shtërpeës. Shtabi prej 11 anëtarësh, ka qenë i angazhuar në të gjithë kohë epidemisë, 24 orë në ditë, sipas nevojave dhe rrethanave. Ky shtabi është takuar rregullisht, ka marrë vendime për monitorimin dhe parandalimin e shfaqjes së mundshme të personave të infektuar në mjedisin tonë. Jemi përkushtuar punës së lokalëve, dyqaneve, në mënyrë që të përdoren pajisje mbrojtëse, maska, doreza dhe dezinfektues. Gjithashtu është monitoruar situata në vikend zonën për shkak të rritjes së numrit të njerëzve që kanë qëndruar atje. Jemi kujdesur për pacientët që ishin larguar nga spitalet, ashtu që këta pacientë kanë qenë në izolim për 14 ditë. Një bashkëpunim i mirë midis shtabit të krizës, strukturave komunale, policisë dhe qendrës

Shëndetësore ka kontribuar në faktin se deri më sot, në territorin tonë nuk është regjistruar asnjë rast me KORONA. Masat e zbatuara nga Qeveria e Kosovës dhe gjendja e jashtëzakonshme me mbylljen e kafeneve, restoranteve, mitingjeve, si dhe kufizimet e lëvizjes, kanë kontribuar në këtë. Gjithashtu kanë një meritë të madhe të gjithë ata njerëzit që kanë respektuar të gjitha masat të cekura. Në Qendrën Shëndetësore në Shtërpçë, të gjitha masat të nevojshme janë marrë në kohë, menjëherë pas shpalljes së pandemisë, sipas rekomandimit të OBSH-së. Ne jemi furnizuar me pajisje mbrojtëse më kohë, ka qenë e detyrueshme të barten pajisje mbrojtëse në Qendrën Shëndetësore, është bërë pastrim të rregullt dysHEMEVE, si dhe sipërfaqeve të punë. Tre here, është bërë dezinfektimi i Qendrës Shëndetësore, dhe të gjitha hapësirave, oborrit dhe veturave e ndihmesë së shpejt, është planifikuar dhe një tjetër dezinfektim pas gjendjes së jashtëzakonshme. Kemi kufizuar frekuencën e pacientëve në Qendrën Shëndetësore, vetëm ndërhyrjet e urgjente, kemi formuar një ekip mobil për vizita dhe ekzaminime të mundshme të pacientëve në shtëpi dhe në izolim. Ne siguroam dy vetura e ndihmës së shpejt për transport, të infektuarave të mundshëm nga COVID, në spitalet, në Graçanicë dhe Prishtinë. Ne kemi hapur një ambulancë e COVID-it, ajo është një dhomë e veçantë për ekzaminimin dhe marrjen e mostrave nga pacientët. Ne kemi marrë teste, dhe tani mundemi të marrim brisë nga pacientë të dyshimtë dhe t'i dërgojmë në Institutin e Shëndetit Publik në Mitrovicë, dhe mund të dërgohet edhe në Prishtinë. Kisha dashur t'i falënderoj të gjithë ata që kanë dhuruar pajisjet e nevojshme mbrojtëse, përkatësisht Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Serbisë, Qeverinë e Kosovës, Ministrinë për Komunitete dhe Kthimi, Kryqin e Kuq të Serbisë, Kryqin e Kuq të Komunës, UNHCR dhe KFOR-in Polak. Në periudhën e ardhshme, rekomandohet që të gjithë punonjësit e shëndetit të bartin pajisje mbrojtëse, si dhe pacientët që vijnë në Qendrën Shëndetësore, gjithashtu në hapësirat e mbyllura dhe në vendet ku qëndrojnë një numër i madh i njerëzve. Epidemia po merr fund, por duhet të kemi kujdes deri sa të shpallet fundi i epidemisë, dmth pandemisë.

Rifat Rustemi: Falënderoj drejtorin që na ka informuar lidhur me situatën e COVID-it, komuna e Shtërpçës është një nga tre komuna që nuk ka pasur asnjë rast, kjo është që qytetaret e kanë qenë ndërgjegjshëm, tu marr parasysh edhe masat që janë ndërmarr nga Qeveria dhe nivelin lokal, na jemi pa asnjë rast me këtë epidemi, ky është lajmi i mirë, edhe për të përshëndetur, por ajo që më ka brengos më shumë sa i përket epidemisë COVID 19, është neglizhenca e ekzekutivit të komunës së Shtërpçës, sepse ju e dini që kemi pasur një panik të qytetaret, kryesisht jam tu fol për kategori sociale, por jo vetëm të kategoria sociale, sepse më këtë epidemi kanë pasur telashe edhe ata që janë pak ekonomish më të fort, për ata sepse kanë menduar që nuk do të mund të gjejnë gjëra ushqimore, e keni pa fluksin e qytetareve tu ble harxh, tu rezervuar si me qenë gjendja e luftës. Janë solidarizuar shumë shoqata humanitare në pjesën shqiptare, për pjesën e serbeve nuk e di si ka qenë gjendja, kush i ka ndihmuar në qet pjesë. Keni pa që komunat e Kosovës e kanë ndarë ndihma qytetareve, gjëra ushqimore. E kanë ndarë buxheti ekstra, janë thirr seanca jashtëzakonshme në atë situatë kritike, janë mbajtur kuvende neper stadione, shtëpia e kulturës, KK Shtërpçës edhe kryetari nuk di që kanë marrë ndonjë iniciativë, qoftë vet si ekzekutiv, me nda mjete për këtë kategori njerëzve, ose me thirr

seancën jashtëzakonshme, për të ndihën qytetarët pak mbështetje e institucioneve lokale, së i përket gjerave elementare. Kisha dashur kryesues me na njoftuar çka ka ndërmarr komuna përveç masave për parandalimin epidemisë, në pjesën serbe a ka ndihmuar dikush në këtë situatë

Predrag Grbić: Drejtori i Financave ka dëgjuar pyetjen tuaj, ai nuk mund të thotë asgjë në lidhje me këtë, as unë nuk mund ta them. Kjo mund të diskutohet kur seanca të mbahet në përbërjen e saj të plotë.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për formimin e grupit punës për hartimin e planit akcional për pjesëmarrjen e publikut në aprovim e buxhetit të komunës për 2021-2023

Predrag Grbic: Kjo është bërë një praktikë, dhe doli të jetë e dobishme, sepse qëllimi i jo vetëm Kuvendit, por i gjithë udhëheqjes komunale, është që të jemi në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, sepse përfshirja e qytetarëve në këtë proces do të na lehtësojë hartimin i buxhetit. Në atë pjesë e buxhetit që ne si komuna mund të ndikojmë. Do të lexoja emrat e propozuar për këtë komision, ato janë: Predrag Grbic, Fikri Hasani, Danijel Vuksanovic, Marjan Spasic, Valjmir Ahmeti, Dimitrije Racicevic, Jeton Rahmani, dhe një përfaqësues nga secila parti politike. Unë do të sugjeroja që, janë të njëjti si në vitin e kaluar, kur bëhet fjalë për anëtarët e Kuvendit, përfaqësuesit të komisionit të jenë: Rifat Rustemi, Garip Sahiti dhe Miroslav Gjordjević. A lajmërohet dikush për fjalë?

Garip Sahiti: Përshëndetje për të gjithë, unë jam për formim i këtij grupit të punues, mirë por, kisha dashur të pyes drejtorin, ose më bërë na një analizë, pasi I dimë që qytetaret po mungojnë në këto debate publike, a është bërë një analizë, për me dit pse nuk vinë qytetaret, a nuk janë marr parasysh kërkesat e tyre, ku qëndron problemi, na pe formojmë grupin transparent gjithmonë, krejt punë shkojnë në mënyrën ligjore, mirë por, ata qe duhet me qenë këtu nuk vinë asnjëherë. Kështu qe na po mblidhemi, pe kryem obligimin që kemi, pse po thirrmi këtë debat e publikut kur ata nuk vinë, është mirë që na si këshilltarët, drejtorja e financave dhe gjithë të tjerë mëremi me këtë çështje pak më shumë, sepse njoftime janë por njerëzit po mungon, kështu që duhet të bëjmë diçka që ata vinë këtu. Ndoshta nuk janë marr parasysh kërkesa e tyre më herët, ose ka një problem. Qeto dy vjet që jemi na në këshilltar, qytetaret çdo here kanë munguar, për shembull, në ato vendbanime shqiptare edhe ato serbe nuk besoj që ka pasur shumë përfaqësuesit

Rifat Rustemi: edhe unë vetëm kisha ndërlidhur në ato që ka thënë zëvendësi i kryesuesit, është një defekt në vërtet ne kohen e fundit, për këtë pjesëmarrjen e qytetareve unë e kam cekur edhe më herët, edhe neper seanca e KK, edhe neper debatet të ndryshme, po besoj që deri sa komuna nuk e merr për bazë, normalisht që kërkesat e qytetareve neper debate publike, ku kanë marr pjesë kanë qenë ndoshta marramendëse, ndoshta as 10% komuna nuk ka mund me përmbush, por

problemi është që janë devijuar ka pak projektet, në kohën e fundit më duket që ka marrë kjo më të mirë, sa i përket investimeve kapitale, për arsye që kërkesa ka shumë, edhe qytetar si qytetar kur merr pjesën në debat, nëse ai flet për ujë të pijes edhe ai tjetër flet për ndriçim, normalisht që komuna duhet me i shenjuri to dy projekte, dhe ata shkojnë më prioritet, uji, kanalizimi, rruga infrastruktura bazë janë në rendin e parë, pastaj vijnë kërkesat të ndriçimit publik, e tjera. Nëse nuk e merr pak me prioritet komuna ato projekte, sidomos në veçanti po flas për investime kapitale, na nuk do të kemi pjesëmarrje qytetareve, ko pak përmirësime por duhet edhe mëshuam me pas për me arit vitin 2012, debatin që ka qenë, 2012, 2013 ose 2011, që ka pasur shumë pjesëmarrje e qytetarëve, që salla ka qenë plot, edhe tu kanë dalë lloj lloj kërkesë, mirë por komuna duhet me marrë më prioritet. Sepse qytetari e sheh, nëse ti e ke qarë ujësjellësin më një lagje edhe ja kë len ndriçimin, ai do të bindet, për ndryshe nuk besoj që do të këtë pjesëmarrje e qytetareve

Predrag Grbic: Ju keni thanë që qytetarët nuk vijnë në debatet publike sepse kërkesat e tyre nuk plotësohen, dhe pastaj ju keni thënë që ka shumë kërkesa por nuk ka fonde të mjaftueshme për të zbatuar të gjitha ato kërkesa. Ne i dimë të gjitha nevojat e qytetarëve tanë, por ne i dimë edhe mundësitë financiare e komunës së Shtërpeës, dhe për fat të mirë ka realizime mëshomë projekteve sesaqë ka pasur kur është miratuar buxheti. Kjo falë udhëheqjes komunale, që të gjen fonde nga burime të ndryshme për zbatimin e disa projekteve, që nuk ishin paraparë gjatë miratimit të buxhetit dhe kanë të bëjnë me investimet kapitale. Shumë pak qytetarë janë përgjigjur dhe kur është fjala për disa projekte që janë lidhur drejtpërdrejt me ata, madje një herë kemi ftuar personalisht prindërit që të marrin pjesë në një debat publik, kur ka qenë fjala për disa masa lidhur me të miturit, në atë debat ishin të pranishëm zero qytetarë. Ka pasur qytetarë të interesuar kur kemi diskutuar për taksat, dhe unë do të doja, natyrisht, që të këtë shumë qytetarë.

Rifat Rustem: Po tentoni që në një formë të më demantoni. Unë i kuptoj mundësi dhe kapacitete e Komunës, i di edhe kërkesat e qytetareve, nevojat në përgjithësi, unë thash, që nëse komuna në bazë e prioriteteve e jep rendësi e projekteve që janë më të rëndësishme, unë jam ai që kam do të siguroj ardhjen e qytetareve, që unë i njoh. Nuk është në rregull më një lagje me pas ujësjellës, kanalizim, infrastrukturë rrugës, asfalt, ndriçim, të asfaltohen rrugica në mes disa shpive, e me një lagje tjetër, mos më pas as rrugë, as kanalizim, as ndriçim, nëse e bëjmë për bazë prioritete, pjesëmarrja do të jetë masive, sa e i kemi mundësi na do të bëjmë. Se qytetari nuk vjen për me ngritur qetësim nëse është e bindur që ajo nuk do të bëhet, parasysh nëse është në pyetje rruga ose diçka tjetër, sepse dikush nuk ka mundësi më bërë me shumë edhe dikush e ka mundësi, ka një fuqi më të madhe edhe e realizon projektin, qetë është dallimi edhe besoj që shumica janë realizuar. Na kemi pa edhe në pjesën shqiptare edhe në pjesën e serbe janë bërë projekte, është mirë me kthye pak dinjiteti

Predrag Grbic: : Këtu bëhet fjala për planin e veprimi, dhe mund të flasim më shumë rreth kësaj kur vjen në rend miratimi i buxhetit. Pasi nuk lajmërohet askush e qes në votim.

Konstatohet që me një zë të njëzë kemi miratuar këtë pikë

5. Propozim dhe shqyrtimi raportit tremujor financiar për periudhën janar-mars 2019 dhe raporti mbi nivelin e pagesës së hyrave vetanake

Danijel Vuksanovic: Siç e dini, ne e kemi miratuar buxhetin në shtator, në shumën totale 4,221,098 €, megjithatë, me përqindje ajo shpërndarja nuk ka qenë ashtu siç është tani, që do të thotë se Qeveria ka miratuar buxhetin me disa ndryshime. Deri më tani kemi pasur 5 kategori të shpenzimeve, por në këtë vit kemi edhe një kategori - rezerva, në shumën totale prej 500,032 €. Kjo shumë do të thotë ulje në kategorinë e pagave. Ne kemi miratuar buxhetin me rritjen e pagave në shtator, por avokati i popullit ka kërkuar që ky ligj të rishikohet dhe pagat nuk janë rritur, dhe ende po mendohet a do të ketë rritje të pagave, apo jo. Shuma totale e komunës varet nga granti i Qeverisë dhe të hyrat vetanake, plani i të hyrave vetanake për vitin 2020 është 489,000 €, ne kemi mbledhur vetëm 12%, për shkak të situatës së re të shkaktuar nga virusi KORONA. Përqindja e shpenzimeve buxhetore me alokime që kemi pasur për këtë periudhë ishte 55%, por kur e krahasojmë kostot me buxhetin e përgjithshëm, përqindja është 13%. Do të shohim se do të jenë të ardhurat në periudhën të ardhshme, por nuk mendoj se do të mbledhim fonde të mjaftueshme nga të hyrat vetanake, dhe për projektet kapitale.

Radojka Repinovic: Ky raport paraqet informacion për buxhetin. Nga kjo ne e shohim që të dhënat e paraqitura na japin një përmbledhje financiare që tregon lëvizjet e buxhetit, nga tremujori i parë i këtij viti. Ne e shohim që po punohet për të ruajtur disiplinën financiare dhe se fondet janë shpenzuar në përputhje me nivelet e ndarjes së buxhetit. Duke marrë përqindjen e shpenzimeve buxhetore, komuna e Shtërpeës është një nga ato institucione që është shumë efikase në punën e saj.

Predrag Grbic: Askush nuk po lajmërohet për fjalë. Kjo pika nuk votohet, kalojmë në pikën e ardhshme

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Drejtorisë për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave „Razim Cokli” në Brod dhe „Anton Santori” në Biti

Sadik Imeri: Përshëndetje për të gjithë pranishëm, nuk do të përsëriti ato që keni marrë në material, kjo pikë ka qenë më herët, konkursi ka qenë anuluar parin herë sepse nuk ka marrë pjesë në intervistë një komisionar nga Ministria e Arsimit, kur së të anëtarë i këshillit të prindërve në nivelin komunal është zëvendësuar, sepse përzgjedhja e anëtarëve të këshillit ka mandat trevjeçar, prej vitit 2020 e tutje, kjo është arsye që kërkojmë që të miratoni prapë një kërkesë të tillë, për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve në dy shkollat e lart cekura

Rifat Rustemi: Kryesuesi ju e dini se kur është aprovuar herën e parë ky komision unë e kam ngritur dilemën e përfaqësuesit e këshillit të prindërve, se nuk kemi pasur procesverbal e ati takimit, kur është zgjedhur përfaqësuesi i këshillit prindërve, dhe mendoj që nuk është praktik e mirë të vazhdojmë kështu, duhet më na dhënë një kopje e procesverbalit. Këtu ka emri dhe mbiemri i përfaqësuesit e këshillit të prindërve, kjo është në rregull, na si përfaqësuesit nuk kemi një dëshmi a është e vërtet përfaqësuesi i prindërve a jo, për këtë arsye nuk e kam votuar, nuk jam kundër, drejtori kur u zgjedh herën e parë më tha që dëshmi e ka në zyrë, mundni me pa edhe procesverbalin, mendoj që nuk është praktika e mirë na që na të shkojmë më p. a është a nuk është, na përfaqësuesit e popullit, nuk jemi për më bërë hetuesi, a ekziston a jo dëshmia, por është mirë kur është fjala të transparencë, më na sjell procesverbal kush është zgjedh për tre vite, kjo është më mirë ma legjitim, ai vjen prej fshatit Brod, krejt në rregull, por apër i kemi njëjtin veprim. Nëse ka mundësi një shpjegim, nga përfaqësuesi i drejtorisë së arsimit, a duhet me qenë si procedurë, a unë jam gabim.

Sadik Imeri: Në material na jemi përmbajtur udhëzimit administrativ e MASHT, për më ardhur në Kuvend kërkesa, sa për zgjedhjes së këshillit prindërve, këto së pari janë kryer neper shkolla dhe pastaj ata anëtar bëjnë zgjidhje e anëtareve të këshillit në nivelin komunal edhe anëtar në letër Dansh Haziri, është anëtar i këshillit të prindërve në nivelin komunal, proceset ekzistoj dëshmi ekzistojnë, janë në dispozicion.

Garip Sahiti: Këto emrat të propozuara për komision, që ka thënë shefi për mendimin temë janë ligjrisht mirë. Por kisha kërkuar nga shefi i drejtorisë që kërkon nga Ministria që koordinohet Drejtorin e Arsimit, që përfaqësuesit e atyre janë prezent, sepse ka thënë që për shkak e mungesës së tij është anuluar edhe konkursi i par, sepse e dimë që shkollat që gati një vjet janë me ushtrues e detyrës, dhe të kryet kjo për të funksionuar puna më mirë në shkollë

Rifat Rustemi: Vetëm edhe diçka për përfaqësuesin e drejtorisë, ndoshta edhe ekzistojnë, njëjtën përgjigje ka dhënë edhe drejtori herën e parë, por është mirë nëse ekziston, më na dhënë ka një kopje, dhe me u bërë si praktik, si shprehje e punës, me na dhënë kopjen e procesverbalit, kush e ka propozuar kur u zgjedh dhe krejt është në rregull, na nuk kishim pasur nevojë që të diskutojm për diçka thjesht, për një kopje dmth, dhe skish pasur nevojë më dhënë asnjë arsyetim, sepse kish kryer puna menjëherë, sepse kjo po e nxit debatin e panevojshëm, pasi ka, thjesht e kopjon një kopje e shtinë në material.

Predrag Grbic: Pasi nuk lajmërohet askush e qes në votim.

Konstatohet që me një zë të njëjti kemi aprovuar këtë pikë

Nuk lajmërohet askush, seanca e sotshme ka përfunduar

Procesmbajtësi
Staja Markovic

Kryesuesi i Kuvendit
Predrag Grbic

